

RAPORT


**I VLERËSIMIT TË JASHTËM, PËR PROGRAMIN E STUDIMIT
2 VJEÇAR, ME KARAKTER PROFESIONAL, PAS ARSIMIT TË
MESËM, NË “DIZAJN GRAFIK”**

OFRUAR NGA “UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA”

Ekspertet e vlerësimit të jashtëm:

Dr. Gjergj Thomai

Dr. Elvan Dajko



Korrik 2019


RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e Studimit 2 vjeçar me karakter profesional,
pas arsimit të mesëm në Dizajn Grafik

Nr.	Tabela e të dhënave për programin e studimit	
1	IAL Aplikues:	Universiteti "Metropolitan Tirana"
2	Departamenti që e ofron	Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës (*) Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit
3	Urdhëri/VKM i licencimit Urdhëri i riorganizimit	Urdhër të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 538 datë 26.10.2017 (në përputhje me VBA Nr. 73 datë 21.09.2017)
4	Titulli i programit të studimit:	Program studimi 2 vjeçar, me karakter profesional pas arsimit të mesëm, në "Dizajn Grafik"
5	Cikli i studimit:	Nuk përfshihet në 3 ciklet e arsimit universitar sipas Bolonjës
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite
7	Kreditet në total (ECTS):	120 Kredite
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet vetëm nga institucioni	PO
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	N/A
12	Diplomë e përbashkët/Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
13	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 5
14	Aktivizimi i programit të studimit	Viti akademik 2017-2018
15	Numri total i studentëve për program studimi	viti 2017-2018 12 studentë viti 2018-2019 9 studentë

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e ASCAL që ndjekin këtë vlerësim

(*) Në aktet e licensimit dhe në formularin e aplikimit ky program ofrohet nga Fakulteti i Inxhinierisë dhe Shkencave të Aplikuara, por me Statutin e ri të institucionit, miratuar me UMASR Nr. 611 datë 28.09.2018, ky fakultet riorganizohet në Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës




HYRJE

Referuar Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për programi i studimit me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, në “Dizajn Grafik” (me tej Program profesional në “Dizajn Grafik”), evidencave bashkëlidhur këtij raporti, si dhe vizitave ne vend, rezulton se Universiteti “Metropolitan Tirana” është licencuar me Vendim Nr.357, datë 12.05.2010 të Këshillit të Ministrave me statusin e Shkollës Private e Arsimit të Lartë “Universiteti Metropolitan Tirana”.

Akreditimi i parë institucional i UMT është bërë me Urdhër të Ministrit përgjegjës për arsimin nr.8 datë 07.01.2016 dhe me VBA nr. 117, datë 15.12.2017 është akreditimi i dytë institucional kryer me QAA (pavarësisht se institucioni ishte brenda afateve ligjore të akreditimit të parë institucional). UMT në përmbushje të kërkesave ligjore dhe të standardeve të cilësisë ka kryer dhe 13 akreditime të programeve të studimit.

Me Urdhrin nr. 611, datë 28.09.2018 të ministrit përgjegjës për arsimin është miratuar Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana, ku dhe mori statusin si universitet.

Universiteti Metropolitan Tirana përbëhet nga 3 fakultete (njësi kryesore), 8 departamente dhe 1 qendër kërkimore (njësi bazë) si më poshtë:

- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT;
- Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës;
- Fakulteti i Ekonomisë.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;
- Departamenti i Inxhinierisë Elektrike dhe Elektronike;
- Qendra Kërkimore Shkencore.

Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
- Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës;
- Departamenti i Shkencave të Natyrës.

Fakulteti i Ekonomisë përbëhet nga:

- Departamenti i Shkencave Administrative;
- Departamenti Financë Bankë;
- Departamenti i Informatikës Ekonomike.

Struktura institucionale (akademike) organizohet në njësi mësimdhënie dhe kërkimi, që mbështeten nga organet administrative. Në Statut përcaktohen qartë edhe rolet e organeve kolegjiale dhe autoriteteve drejtuese të institucionit: Bordit të Administrimit, Senatit Akademik, Komisioneve të Përhershme, Këshillit të Etikës, Këshillit të Sigurimit të Cilësisë, Rektorit, Administratorit, dekanëve dhe përgjegjësve të departamenteve.

Statuti i UMT (dokumenti bazë i institucionit) përcakton marrëdhënien ndërmjet shoqërisë themeluese dhe strukturave institucionale, duke përfshirë autonominë e secilit subjekt dhe ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi. UMT garanton autonomi të plotë dhe liri akademike në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, në përputhje me Statutin e UMT-së, përkatësisht për përzgjedhjen e stafit, për ofrimin e programeve të studimit, për ngritjen dhe konsolidimin e bashkëpunimeve me institucione të tjera të arsimit të lartë apo organizata të tjera, për të pranuar studentë dhe për të menaxhuar burimet në pronësi të ligjshme të institucionit (*deklaruar ne RVB*).

Programi profesional 2 vjeçar në “Dizajn Grafik” është licencuar për herë të parë me Urdhër të MAS nr. 538, datë 26.10.2017 “Për hapjen e programit të studimit dyvjeçar në Grafik Dizajn”, me kohëzgjatje 2 vite

akademike me kohë të plotë, me 120 ECTS, e në përfundim të programit pritet të lëshohet diploma me emërtimin: “Diplomë profesionale në Dizajn Grafik”.

Ky program studimi ofrohet nën përgjegjësinë e Departamentit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, por për pjesën akademike angazhohen dhe staf akademik i 2 fakulteteve të tjera të UMT-së.

Në takimin me zv/Rektorin dhe drejtues të tjerë, na u prezantua zhvillimi i institucionit, dhe specifika strategjia e UMT si universitet në vitet e ardhshme.

GRUPI I VLERESIMIT TE JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Dr. Gjergj Thomai

Dr. Elvan Dajko

Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është bërë nga ASCAL /Bordi i Akreditimit. Menaxheri teknik (MT) i ndjekjes së vlerësimit të kësaj procedure është specialisti i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

Më datë 01.07.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 47/20 Prot., datë 01.07.2019 “*Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm*”, UMT është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Më datë 02.07.2019, “UMT” përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft –Raportin, me shkresë Nr. 134 Prot., datë 02.07.2019 “*Lidhur me draft Raportet e vlerësimit të jashtëm për procesin e akreditimit të pjesshëm institucional dhe për procesin e akreditimit të programit profesional 2 vjeçar të studimit në Dizajn Grafik*”.

Në këtë dokument institucioni nuk ka bërë komente për Draft-RVJ dhe është dakort me vlerësimin. Draft Raporti është edhe Raporti përfundimtar.

1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit (pika 2.3 të VKM nr. 41/2018), mësimdhënia, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për programin e studimit (historiku, numri i punonjësve në vite, numri i studentëve në vite, vendi i Programit të studimit në kuadrin e kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programi i studimit Profesional në “Dizajn Grafik”, në vlerësimin tonë mendojmë se ofrohet në përputhje me misionin dhe objektivat e Universitetit Metropolitan Tirana, duke qenë se dhe profili i këtij institucioni është në fushën e ndërtimit e arkitekturës, si dhe në fushën e teknologjisë së informacionit e të sipërmarrjes (ekonomike), gjë që mundëson më së miri ofrimin e këtij programi profesional studimi, në plotësim të kërkesave të tregut të punës për këtë kategori profesionistësh.

Programi i studimit profesional 2 vjeçar “Dizajn Grafik” (PDG) mundëson formimin e profesionistëve në fushën e Dizajnit Grafik, si dhe orienton ata drejt tregut të punës, vendas dhe të huaj, në plotësim të kërkesave të punësimit për këtë lloj profesioni.

Programi profesional synon t’i japë studentëve njohuri formuese dhe praktike bazë për dizajnin grafik. Në RVB është deklaruar se: “*Programi profesional në dizajn grafik synon të përgatisë studentët në formimin e një aftësie kritike në një fushë profesionale të dizajnit grafik, dizajnit editorial, dizajnit të markave dhe ambalazhimeve dizajnim në sektorin e prodhimit të reklamave etj.*

Programi i studimit i shërben edhe ndryshimit të mentalitetit për një ndërgjegjësim më të madh të studentëve për arsimin profesional si një arsim me shumë të ardhme në Shqipëri. Studentët gjatë zhvillimit të këtij programi studimi, aftësohen në përdorimin e teknikave, metodave dhe mjeteve të dizajn grafikës gjatë studimeve të tyre.

Në vlerësimin tonë rezulton se synimi i programit të studimit është në përputhje me kurrikulën e ofruar, të cilat konsistojnë në:

Përgatitjen e studentëve më njohuri bazë, profesionale dhe praktike në fushën e Dizajnit Grafik, si dhe pajisjen e tyre me kompetenca për specializime apo trajnime në këtë fushë.

Pajisjen e studentëve me njohuri dhe aftësi të nevojshme për formimin e profesionistëve të dizajn grafikës, si dhe aftësimin e tyre për të konkurruar në tregun vendas dhe të huaj.

Aftësimin në ushtrimin e veprimtarise konkrete profesionale si: dizenjim grafik, dizenjim editorial, Ilustrim, dizenjim i markave dhe ambalazhimeve, dizenjim në sektorin e prodhimit të reklamave, interiere, etj.

Vlerësimi sipas standardeve

Standardi 1: Aftësitë specifike të lidhura me sektorin e punësimit janë zhvilluar, monitoruar dhe vlerësuar gjatë gjithë zhvillimit të programit të studimit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

- Kriteri 1** Punësimi është trajtuar në hartimin e kurrikulave, në karrierën arsimimin, informimin dhe udhëzimet.
- Kriteri 2** Punësimi është një çështje kyçe për miratimin e programit, monitorimin dhe rishikimin e tij.
- Kriteri 3** Studentëve i është dhënë mbështetje për zhvillimin e aftësive në funksion të punësimit.
- Kriteri 4** Programi parashikon dhe kredite të përfituara gjatë punës
- Kriteri 5** Të përfshijnë inisiativa specifike si psh. mbështetje për sipërmarrjen
- Kriteri 6** Krijimi i lidhjeve punëdhënës / IAL.

Vlerësimi sipas standardit 1:

Kurrikula e programit DG (plani mësimor dhe syllabuset) janë hartuar duke analizuar me kujdes nevojat e tregut të punës si dhe nevojat në burime njerëzore të kompanive që operojnë në tregun e punës. Programi i studimit synon formimin praktik të studentëve. Dedikimi i ambienteve/hapësirave (në UMT) laboratorëve informatikë apo të dizenjimit artistik, dhe në ambientet e kompanive që operojnë në tregun e dizenjimit grafik (ku kryhen praktikat) për studentët e këtij programi, është në funksionit të synimit parësor të PDG, aftësimin praktik për procese të ndryshme të dizenjimit (nga RVB).

Në planin mësimor të diplomës profesional Dizajn Grafik, raporti i orëve teori dhe praktikë rezulton afërsisht 1:2, raport ky brenda kërkesave të Kornizës europiane të kualifikimeve dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (nga RVB). Në këtë kontekst UMT-ja ka lidhur marrëveshje konkrete me disa prej kompanive të fushës së dizajnit grafik në mbështetje të programit të studimit. Praktikrat në këto biznese, kishin si qëllim përveç aftësimin praktik dhe krijimin e një modeli edukimi të qëndrueshëm dhe sa më pranë përvojës kombëtare, duke u përshtatur me specifikat lokale.

Rishikimi i planit mësimor dhe syllabuseve të programit të Dizajn Grafik, është bërë në vitin e dytë të ofrimit të tij, në plotësim të kërkesave të VKM nr. 4/2018, si dhe të rishikimit periodike të syllabuseve të programit. Nga takimi me GVB dhe stafin akademik të programit u konstatua se rishikimi i syllabuse ishte praktikë e përvitshme që ndiqej për të gjitha programet e studimit.

Nga GVB u referua se lidhur me planin mësimor të programit profesional në Dizajn Grafik, koordinatori i programit ka bërë takime me kompanitë në të cilat zhvillohen praktikrat, kjo në plotësim të nevojave dhe kërkesave të tregut, si dhe të zhvillimit afatgjatë të vetë kompanive që operojnë në tregun e punës, për te plotësuar nevojat e tyre me punonjës të trajnuar dhe të aftë e të realizojnë shërbime cilësore në fushën e dizajnit

grafik.

Të diplomuarit në DP në Dizajn Grafik mund të punësohen në kompani apo ndërmarrje që ofrojnë shërbime në dizajnime, po ashtu mund të punojnë edhe të pavarur, duke ofruar shërbime në këtë fushë.

Aftësimi specifik praktik i studentëve rezulton të jetë i lidhur ngushtë me sektorin e punësimit (kjo nga takimi me studentët).

Konkluzionet e GVJ:

Për programin e studimit profesional në Dizajn Grafik, institucioni rezulton të jetë mbështetur në eksperiencën evropiane për këto programe, si dhe kërkesat e tregut të punës për këtë profesion. Rishikimi dhe përditësimi i programit të studimit, është një proces që UMT-ja e kryen në vijimësi, duke bërë monitorimin e pajisjes me aftësi specifike praktike të studentëve të lidhura me sektorin e punësimit.

Aftësimi praktik i studentëve rezulton të jetë i lidhur ngushtë me sektorin e punësimit kjo konfirmuar dhe nga takimet me studentët dhe me koordinatorin e programit të studimit.

2. Struktura akademike e Njesisë Kryesore/ Njesisë Bazë (përgjegjëse për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për personelin akademik në njësinë bazë, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ, koordinimi i mësimdhënies me njësi të tjera të institucionit.

Në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, si dhe në Statutin e UMT [Aneksi 4 i RVB: Statuti i UMT, shtojca 2] është përcaktuar struktura organizative akademike e universitetit. Në këtë strukturë janë përcaktuar njësitë përbërëse, funksionet dhe kompetencat, lidhjet dhe varësitë ndërmjet tyre, me qëllim mirëfunksionimin e institucionit në përmbushje të misionit, synimeve dhe objektivave të tij.

Programi i studimit 2 vjeçar profesional në Dizajn Grafik ofrohet nga **Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës (FIA)**, dhe **njësia bazë** përgjegjëse është **Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës**. Oferta akademike e këtij programi studimit profesional mbështetet me staf akademik dhe nga dy fakultetet e tjera të UMT, përkatësisht Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT dhe Fakulteti i Ekonomisë.

Struktura akademike në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës që ofron programin DG, është si më poshtë:

- Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës: 7 pedagogë me kualifikimin 2 Prof. As/1 Dr/2 Msc në proces doktorate/2 Msc)
- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit: 7 pedagogë me kualifikimin 1 Prof Dr./0 Prof.As/2 Dr/2 Msc në proces doktorate/2 Msc);
- Departamenti i Shkencave të Natyrës: 7 pedagogë me kualifikimin 2 Prof. Dr/1 Prof. As/1 Doc/2 Msc në proces doktorate/1 Msc)

Numri i personelit akademik efektiv, personelit akademik me kontratë (të jashtëm) dhe personelit akademik të ftuar, sipas fakultetit /Departamentit që ofron programin DP në Dizajn Grafik (të konfirmuar dhe gjatë vizitës në vend) jepet në Tabelën 1.1 (ne Aneks):

Të dhënat sipas kualifikimit të stafit akademik (PAE dhe PAK) të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës; Raportet midis tyre jepet në Tabelen 1.2 (ne Aneks):

Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për Njësinë Bazë, përgjegjëse të programit të studimit dhe njësitë e tjera të Fakultetit jepet në Tabelën 2 (ne Aneks):

Konkluzione të vlerësimit:

Struktura akademike e UMT-së (referuar RVB), specifikisht njësia kryesore (fakulteti) dhe njësitë bazë të saj (departamentet) që ofrojnë programin e studimit profesional në Dizajn Grafik, plotësojnë kriteret ligjore të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH". Rekrutimi i stafit me eksperiencë akademike dhe profesionale në fushën e dizenjimit është prioritet i institucionit.

3. Personeli akademik dhe ai mbështetës për Programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik për programin e Studimit profesional në "Dizajn Grafik" është përzgjedhur bazuar fushat specifike akademike dhe në eksperiencat praktike e profesionale të tyre. Personeli akademik i përket fushës së dizenjimit dhe grafikës (dizenjues grafike dhe arkitekte) apo në fusha të ngjashme, si dhe me eksperiencë në mësimdhënie si dhe aplikimet praktike.

Procesi i rekrutimit të personelit akademik bëhet në përputhje me procedurat e miratuara nga UMT-ja për këtë qëllim (identifikimi i nevojave dhe përcaktimi i kriterëve bëhet nga njësia bazë) Shpallja e vendit/ve vakante, afateve të aplikimit, si dhe kriteret përkatëse bëhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore të UMT, në faqen zyrtare të institucionit.

Komisioni i Vlerësimi (komision ad hoc) është përgjegjës për vlerësimin e aplikantëve. Kandidatët fitues për vendin vakant, komisioni ia përcjell Rektorit të Universitetit i cili bën dhe emërimin në detyrë të personelit akademik.



Llojet e kontratave të punës që lidh institucioni më të punësuarit në UMT janë:

- Kontrata e stafit akademik me kohë të plotë;
- Kontrata e stafit akademik me kohë të pjesshme;
- Kontrata e stafit administrativ.

Çdo fillim viti akademik, njësia bazë (departamenti) planifikon shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me kualifikimin e stafit dhe me përvojat akademike të tij, si dhe në përputhje me aktet normative për ngarkesën vjetore të stafit, duke mundësuar dhe hapësira për stafin akademik lidhur me angazhimin e tyre në studime, hulumtime shkencore të fushës.

Cilësia e stafit akademik dhe ndihmës akademik për programin e studimit jepet në Tabelat 3 Shpërndarja e ngarkesës mësimore behet që në muajin korrik të vitit akademik në përputhje me normativat e ngarkesës mësimore të UMT, duke identifikuar dhe nevojat për mbulimin e disiplinave/lëndëve përkatëse më staf akademik të jashtëm.

Gjatë vizitës në vend GVJ u njoh me: Procedurat e pranimit në UMT; Llojet e kontratave dhe modelet e tyre; Ngarkesën semestrale të pedagogëve; etj



GVJ pa dosje të stafit akademik të brendshëm dhe staf akademik me kontrate , të cilat rezultuan në përputhje të plotë me kërkesat ligjore përkatëse.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi 2 Aftësi të transferueshme janë zhvilluar, monitoruar dhe vlerësuar gjatë gjithë programit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Punëdhënësit ndihmojnë në përcaktimin e përvojave thelbësore (p.sh. përvoja e punës) dhe aftësitë ndër-kurrikulare, qëndrimet dhe njohuritë (p.sh. të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, komunikimi, TIK, marrëdhëniet me klientët)

Kriteri 2 Çdo aftësi është ndjekur përmes moduleve (Përmbajtja e kursit, metodat e mësimdhënies, vlerësimit) në fazat e zhvillimit të kurrikulës dhe nëpërmjet rishikimit të programit.

Kriteri 3 Rezultatet janë të monitoruara (p.sh. punësimi i të diplomuarve).

Vlerësimi sipas standardit 2:

Nga takimet me zv. Rektorin, dekanin, pergjegjësën e departamentit si dhe me stafin akademik të programit të studimit profesional në Dizajn grafik, rezulton se UMT-ja reflekton zhvillimet e reja në ekonomi si dhe zhvillimet e tregut të punës për të gjitha programet e studimit që ofron e specifikisht për programin në fjalë.

Programi i studimit profesional në Dizajn Grafik rishikohet periodikisht për përmirësimin në elementë të tij (shpërndarja ngarkesës mësimore në favor të orëve të fortimit praktik, metoda mësimdhënies, metodat e vlerësimit të lëndës/modulit etj) në funksion të zhvillimit të aftësive specike të studentit nëpërmjet moduleve/lëndëve të programit.

Për rishikimin e kurrikulës së programit DG, janë organizuar diskutime në nivel Departamenti, Fakulteti dhe në Senatin Akademik [Aneksi 8 RVB: Procedura e rishikimit të programeve të studimit]. Një pjesë të propozimeve kanë ardhur nga pedagogë të cilët kanë përfunduar studimet apo kanë kualifikime jashtë vendit në fushën e dizajnit, si dhe sugjerime nga biznesi i fushës, konkretisht:

Për metodat e mësimdhënies, duke futur metoda interaktive e të aplikuara në mësimdhënie për të arritur aftësi të mira profesionale, aftësi gjyqësive si dhe komunikim, gjithashtu që stimulojnë pjesëmarrjen e studentëve si dhe ndërveprimin në klasë, si:

- a) *Puna në grup: ku krahas projekteve individuale, studentët punojnë në grupe, që është një aftësi e kërkuar në tregun e punës dhe e rëndësishme në profesionin e dizajnit grafik, në të cilën ndërveprojnë shumë aktorë të ndryshëm (RVB);*
- b) *Prezantime në klasë: ku studentëve iu kërkohet të bëjnë prezantime, të cilat lidhen me punët e tyre origjinale. Këto prezantime rrisin komunikimin (RVB).*
- c) *Përdorimi i teknologjive të reja (gjatë procesit të mësimdhënies): veçanërisht e rëndësishme për programin e studimit janë njohja me grafikën kompjuterike, teknikat e fundit të modelimit digjital 3D, elementë të grafikës editoriale etj. Në funksion të tyre janë pajisje dhe softuerë të kohëve të fundit dhe të përshtatshëm që studentët të asimilojnë njohuritë e tyre praktike si dhe të praktikohen në aspekte të veçanta të profesionit (RVB).*
- d) *Vizita në terren: në disa lëndë janë përdorur vizitat në terren në kompani të dizajnit ku studentët mund të shohin nga afër implementime të programeve shtetërore apo aspekte të tjera, të cilat nuk mund të demonstrohen apo aplikohen në UMT (RVB).*

Gjithashtu për disa lëndë ishte rishikuar metodologjia e vlerësimit të lëndës duke bërë të mundur jo vetëm kontrollin e dijeve por kreativitetin e studentit (kjo nga takimi me GVB, stafin akademik dhe studentët).

Procesi i mësimdhënies monitorohet nga drejtuesi i departamentit, koordinatori i programit dhe zyra e

cilësisë, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies, adaptimit të metodave të aplikuara të mësimdhënies.

Standardi 5: Stafit zotëron aftësi, sjellje dhe përvojë të duhur për rezultatet e pritshme të programit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Të dhëna nga specialistë të sektorit përkatës të punësimit

Kriteri 2 Stafit mësimdhënës angazhohet në përditësimin e mëtejshëm, specifikisht për anën profesionale, lëndët dhe vendet e punës

Kriteri 3 Janë ngritur sisteme për evidentimin e hershëm dhe ofrimin e mbështetjes, për mbështetjen e të mësuarit tek studentët

Kriteri 4 Stafit ka siguruar mbështetje për studentët me kohë të pjeshme (part time), p.sh. nëpërmjet email-it, ofrimit të të mësuarit virtual dhe ambienteve përkatëse (e-learning).

Vlerësimi sipas standardit 5:

Rekrutimi dhe përzgjedhja e stafit akademik për programin profesional në Dizajn Grafik është bërë në përputhje me specifikat e këtij programi profesional. Janë angazhuar staf akademik që ka përvojë dhe formim të përshtatshëm akademik dhe/ose profesional në fushën e dizenjimit (kjo dhe nga njohja mes kolegëve në nivele akademik e profesionale).

Nga takimet gjatë vizitës në vend, u evidentua fakti që mund të ofroreshin nga UMT-ja kurse trajnimi të shkurtra specifike të përditësuar, si për të diplomuarit e UMT në këtë program studimi, duke siguruar që ata të kenë një edukim në vazhdim të përditësuar, ashtu dhe për punonjësit e kompanive që operojnë në fushën e dizenjimit.

Drejtorja e Komunikimit dhe Marrëdhënive me Jashtë është struktura e cila ofron dhe garanton mbështetje për studentët. Studentët marrin informacion nëpërmjet materialeve të printuara si programe studimi, broshura, 'Guida e studentëve', faqes zyrtare e UMT (www.umat.edu.al). Për programet që UMT ofron, aktivitetet që zhvillohen aty, etj.,

Portali zyrtar i UMT (ku kanë akses personeli akademik, studentët dhe personeli administrative i UMT) është një burim informacioni personal për studentët si nota, pjesëmarrje në klasë, njoftime të ndryshme, detyrime të studentit, etj. UMT përveç mënyrave të mësipërme të ofrimit të informacionit, përdor dhe rrjetet sociale si Facebook, Twitter, LinkedIn, etj.

Konkluzionet e GVJ:

Drejtuesi i departamentit, koordinatori i programit dhe zyra e cilësisë monitorojnë në vijimësi programin e studimit, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies, adaptimit të metodave të aplikuara të mësimdhënies.

Koordinatori i programit mban kontakte në vazhdimësi me kompanitë në të cilat zhvillohet praktika profesionale si dhe identifikon nevojat dhe kërkesat e punëdhënësve për këtë program, si dhe i adreson ato në departament. Përmirësimet e bëra në kurrikulën e programit të studimit, vlerësojmë se janë efektive në rritjen e cilësisë së ofrimit të programit të studimit në funksion të formimit të studentëve.

Përzgjedhja e stafit akademik për programin profesional në "Dizajn Grafik", bazuar në specifikën e këtij programi (profesional), duke angazhuar konkretisht staf akademik, që ka përvojë dhe formim të përshtatshëm akademik dhe/ose profesional në fushën e dizenjimit është në drejtimin e duhur të rritjes së cilësisë të procesit të mësimdhënies.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residenat.

Universiteti Metropolitan Tirana e zhvillon veprimtarinë e vet mësimore në 3 godina (RVB);

- në godinën qendrore në Rrugën “Sotir Kolea”, me sipërfaqe 2350 m²
- në godinën në Rrugën “Budi”, me sipërfaqe 2490 m²
- në godinën në Rrugën “Brigada VIII”, me një sipërfaqe 717 m²

Godinat në të cilat zhvillohet procesi i mësimdhënies, janë godina të reja, të ndërtuar vitet e fundit, me standarde të larta ndërtimore si dhe që përmbushin kriteret për zhvillimin e aktiviteteve mësimore.

Ambientet ku zhvillohet kërkimi, mësimi dhe zyrat janë të pajisura në përshtatje me funksionin që ato kryejnë, të ndriçuar maksimalisht, me mbi 20% ndriçim natyral, me akustikë të përshtatshme, me sistem individual kondicionimi dhe me inverter për ngrohje dhe ftohje. Lartësia e ambienteve është jo më e vogël se 3.0 m (tavan - dysheme). Sallat për mësimdhënie janë të pajisura me projektorë, me qasje në internet nga çdo vendndodhje në hapësirën e godinës.

Ambientet janë të pajisur me sistem mbrojtës kundra zjarrit të lëvizshëm dhe statik, me mjetet e nevojshme të ndihmës së shpejtë për çdo kat, me furnizim të pandërprerë me ujë falë depozitave të ujit me vëllim të mjaftueshëm, me sistem alternativ në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike nga rrjeti dhe me ambiente të shërbimit për nevoja personale në çdo kat.

Për zhvillimin e procesit mësimor dhe ambienteve në funksion të studentit janë ambientet e dhena ne Tabelat 4, ne Aneks). Aty rezulton se UMT ka ambiente të mjaftueshme për mësimdhënien.

Programi 2 vjeçar me karakter Profesional në “Dizajn Grafik” zhvillohet në ambientet e godinës qendrore në Rrugën “Brigada e VIII”. Përzgjedhja e këtij mjedisi mësimor është bërë mbështetur në përshtatshmërinë e kushteve të ofruara nga ambientet e kësaj godine me programin mësimor si edhe pozicionimi në të njëjtën godinë ku zhvillohen programe të fushave të ngjashme me të.

Ndërtesa e shkollës ka hapësira të bollshme të mbyllura e të hapura (oborr) e pozicionuar në një hapësire strategjike për zhvillimin e procesit mësimor jo vetëm në klase por edhe në ambiente të hapura, pranë parkut periferik të qytetit si edhe kompanive që zhvillojnë aktivitetet në fushën e grafikës.

Klasat e pajisura me kompjuter për të zhvilluar komponentët mësimorë dhe praktikë të grafikës kompjuterike. Në funksion të studentëve janë vënë edhe pajisje të vizatimit më dore të lire si kavaleta, telajo, etj që mundësojnë vizatimin edhe në ambiente të hapura.

Tregues të matshëm:

- Mjediset e institucionit në funksion të programit të studimit** (Tabela 4, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Në vlerësimin tonë, infrastruktura e institucionit në dispozicion të këtij programi studimi është mëse e mjaftueshme.

Konkluzionet e GVJ:

Programi 2 vjeçar me karakter Profesional në “Dizajn Grafik” zhvillohet në ambientet e godinës qendrore

në Rrugën “Brigada e VIII”. Kushtet infrastrukturore të ofruara në ambientet e kësaj godine janë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor të programit.

Klasat janë të mirëpajisura me kompjuter për të zhvilluar komponentët mësimorë dhe praktikë të grafikës kompjuterike.

Në funksion të studentëve janë vënë edhe pajisje të vizatimit me dore të lire si kavaleta, telajo, etj që mundësojnë vizatimin edhe në ambiente të hapura.

Vlerësojmë faktin që UMT –ja pajis me laptop studentin (që në vitin e parë) duke mundësuar atyre vënien në praktikë të njohurive të fituara.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, shpenzimet, kostoja për student, kontrolli financiar, kapacitetet menaxhuese.

Referuar Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, rezulton se UMT-ja ka qëndrueshmëri financiare. Zyra e financës është struktura që raporton periodikisht në Bordin e Administrimit lidhur me aktivitetin dhe treguesit financiar të UMT-së. Për auditimin e pasqyrave financiare dhe mbi zbatimin e standardeve të raportimit financiar, është përgjegjës një kompani auditimi (e jashtme).

Kapacitetet e menaxhimit financiar të UMT mbështeten në një linjë të proceseve dhe dokumenteve që UMT mban të tilla si: aplikimi i praktikave kontabël në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat janë të shprehura qartë dhe të vlefshme për Bordin e Administrimit dhe personelin drejtues; Monitorimi i buxhetit në baza faktike dhe / ose krahasuese për të arritur një perceptim më të mirë të financave; përgatitjen e parashikimeve të fluksit së parasë dhe parashikimin e të ardhurave të fundvitit, shpenzimet dhe kostot e studentëve për të ndihmuar në marrjen e vendimeve të shëndosha të menaxhimit gjatë vitit (RVB).

Të ardhurat financiare janë paraqitur në Tabelën 5.1 në Aneks

Në kuadër të Raportit Vjetor të mësidhenies, kërkimit shkencor dhe financiar, UMT bën analizën e kostos së të gjitha programeve të studimeve. Kjo analizë përmban:

- Shpenzimet operacionale: koston e mësidhënies, pagat e stafin mbështetës administrativ si dhe shpenzimet e tjera operacionale si qeraja, energjia elektrike / telefon / interneti etj që lidhen me këto programe
- Shpenzimet kapitale (Investime): kostoja e aseteve të blera për drejtimin e programeve akademike si kompjuterët dhe pajisjet IT, labororet e programeve inxhinierike, mobiljet dhe asetet e tjera, si dhe kostoja e aktiveve të patrupëzuara si blerja e licencave për programet softuerike, tarifatat e akreditimit, bibliotekat elektronike.

Analiza e kostos së programeve shqyrtohet në raport me të ardhurat e gjeneruara nga programet. Analiza e fitimit / humbjes kryhet për secilin program dhe nëse është e nevojshme modifikimet e duhura të komponentëve të caktuar të kostos bëhen për vitin e ardhshëm akademik.

Kostoja për student për programin profesional në “Dizajn Grafik” paraqitet në Tabelën 5.2 (në Aneks)

Konkluzionet e GVJ:

Bordi i Administrimit të UMT për përcaktimin e planeve financiare në mbështetje të zhvillimit të programeve të studimit dhe specifikisht programin profesional në “Dizajn Grafik” me qëllim sigurimin e

stabilitetit dhe qëndrueshmërisë financiare të institucionit, bazohet në treguesit dhe raportet financiare të gjeneruara nga zyra e financës së institucionit.

Kapacitetet e menaxhimit financiar të UMT mbështeten në një linjë të proceseve dhe dokumenteve që UMT mban (aplikimi i praktikave kontabël në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat janë të shprehura qartë dhe të vlefshme për Bordin e Administrimit dhe personelin drejtues; Monitorimi i buxhetit në baza faktike dhe / ose krahasuese për të arritur një perceptim më të mirë të financave; përgatitjen e parashikimeve të fluksit së parasë dhe parashikimin e të ardhurave të fundvitit, shpenzimet dhe kostot e studentëve për të ndihmuar në marrjen e vendimeve të shëndosha të menaxhimit financiar gjatë vitit).

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, në funksion të programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Funksionimi i Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NjBSC), i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), ngritur në nivel institucional ka si qëllim vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së veprimtarive akademike dhe komponentëve përbërës të tyre si: programeve të studimit, stafit akademik, administrativ dhe ndihmës, studentëve, mësimdhënies, infrastrukturës dhe shërbimeve të tjera që ofron.

Proceset e vlerësimit të cilësisë që kryen NJSBC konsistojnë në evidencime, rishikime periodike të proceseve akademike, rekomandime, plane masash, garantojnë që veprimtaritë akademike të shihen si procese në përmirësim të vazhdueshëm në funksion të rritjes së cilësisë.

Kjo njësi realizonte përveç përdorimit periodikisht të pyetësorëve me studentët në kuadër të tërheqjes së opinionit të tyre mbi programin e studimit, për çdo lëndë të programit dhe pedagog, dhe në rrugë të drejtpërdrejta takime/biseda të drejtuesve të institucionit me studentët.

Nga rezultatet e gjetjeve gjatë proceseve të vlerësimit të njësisë, ajo kishte evidentuar faktin që përveç forcimit të rolit të departamentit në proceset akademike, njësitë bazë specifikisht për programet profesionale të evidentonin forma të reja për kontrollin e dijeve të fituara nga studentët duke i dhënë përparësi punës individuale të studentëve (nëpërmjet rasteve të studimit apo detyrave të kursit).

NJSBC vazhdimisht bënte rishikimin/përmirësimin e vazhdueshëm të pyetësorëve, me qëllim objektivitetin në matjen e kënaqësisë së studentit lidhur me aspekte akademike (nga RVB dhe takimi me NJSBC). Aktualisht NJSBC në bashkëpunim me titullarët e njësive kryesore dhe njësive bazë dhe stafin akademik, kishte në proces hartimin e kriterëve të vlerësimit të performancës lidhur me angazhimin konkret të pedagogut në kërkimin shkencor brenda dhe jashtë vendit.

Të dhëna për anëtarët e NJSBC jepen në Tabelën 6 (në Aneks)

NJSBC ka në përberjen e saj individë me eksperiencë në proceset e vlerësimit të brendshëm në nivel institucional apo programesh studimi. Senanti Akademik, në konstituimin e NJSBC ka mbajtur parasysh dhe kriterin e rinovimit të pjesshëm të tyre për të siguruar kalimin organik e të qëndrueshëm të përvojës në vazhdimësi.

Lidhur me anketimet e kryera nga NJSBC me studentët e programit të GD, të dhënat janë si më poshtë (RVB):

- Anketime me studentët e programit të studimit (2 anketime)
- Studentë janë anketuar (14 studentë nga 21 në total)
- Përpunimi i pyetësorëve (76 pyetësorë)

Konkluzionet e GVJ:

Në vlerësimin e GVJ, proceset e vlerësimit të cilësisë që kryen NJSBC (rishikime periodike të proceseve akademike, rekomandime, plane masash), garantojnë që veprimtaritë akademike të shihen si procese në përmirësim të vazhdueshëm në funksion të rritjes së cilësisë.

NJSBC (struktura përgjegjëse për cilësinë) realizon në rrugë të drejtpërdrejta (takime/biseda të drejtuesve të institucionit me studentët) apo të tërthorta (përdorimi periodikisht i pyetësorëve me studentët në kuadër të tërheqjes së opinionit të tyre mbi programin e studimit, për çdo lëndë të programit dhe pedagog) dhe pas procesit të përpunimit të gjetjeve, rezultatet i adresohen individit/titullarit apo strukturës/ave përgjegjëse.

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (pika 2 e VKM nr. 41/2018)

Programi profesional në “Dizajn Grafik” ka si objektiv të *pajisë studentët me njohuri teorike bazike dhe kryesisht aftësi praktike në fushën e dizenjimit grafik*. Ky program mundëson zotërimin e njohurive të thelluara profesionale në disiplina specifike të dizenjimit siç janë: dizenjimi grafik, multimedia, web dizajn, dizajn interieri etj, të cilat janë më të kërkuara në tregun e punës në Shqipëri.

Të dhënat kryesore janë:

- | | |
|---|---|
| a) Emërtimi i Programit: | Program studimi 2 vjeçar, me karakter profesional pas arsimit të mesëm, në “Dizajn Grafik” |
| b) Kohëzgjatja e Programit të Studimit: | 2 vite akademike |
| c) ECTS totale: | 120 ECTS |
| d) Forma e studimit: | me kohë të plotë |
| e) Vendi në KSHK: | Niveli 5 |

Aftësimi praktik dhe profesional i studentëve realizohet nëpërmjet detyrave të kursit dhe praktikave, ku student aftësohet në përdorimin e teknikave të njohura figurative, (vizatim, temper, tush, pastel) dhe me programe kompjuterike, (CorelDRAW, Adobe Photoshop, Adobe InDesign, Adobe Illustrator, etj), të cilat zhvillohen në laboratorët informatike të UMT-së.

Tabela e planit mësimor për dy vitet akademike jepet në Tabelën 7 (në Aneks)

Përmirësimet në ngarkesën mësimore sipas formave të mësimdhënies të programit GD jepet në Tabelën 8 (në aneks)

Përsa i përket ndryshimeve/përmirësimit në planin mësimor të programit profesional në Dizajn grafik (referuar planit mësimor të licencuar), UMT-ja ka bërë këto ndryshime:

1. Është bërë rigrupimi i lëndëve sipas veprimtarive formuese nga A-E (shih tabela 9) në plotësim të kërkesave të VKM nr.41/2018 (nga A në F që ishte)
2. Në vitin akademik 2018-2019, në kuadër të rishikimit periodik të programeve të studimit në UMT, është rishikuar raporti i orëve teori /praktikë në funksion të rritjes së orëve praktike (shih Tabela 8 në aneks)

Mendimi i GVJ është se këto ndryshime janë bërë në drejtimin e duhur të rritjes së kompetencave profesionale të studentit.

Kuadri i përgjithshëm formues i Programit të studimit dhe ndarja e lëndëve sipas tipit të veprimtarive (nga A-E), mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës në vend (Tabela 9):

Vlerësimi i Syllabus-eve për çdo lëndë.

Elementët e syllabuseve të sjella si evidencë plotësuese e RVB janë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Emri i titullarit / pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Ngarkesa: (numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion dhe seminar, praktika etj.)
- Tipologjia e lëndës
- Viti akademik/semestri kur zhvillohet lënda
- Lloji i lëndës: (e detyrueshme ose me zgjedhje)
- Programi i studimit: (programi për të cilin ofrohet kjo lëndë)
- Kodi i lëndës
- Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës
- Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit: (Përmbledhja është një abstrakt që jep idenë e përgjithshme të kursit. Objektivat e lëndës janë synimet që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj, të cilat ndahen në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studentit pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës)
- Konceptet themelore: (Janë koncepte e terma bazë mbi të cilat ndërtohet lënda)
- Temat e lëndës (shpjegimi (rreth një paragraf) i cdo teme të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe))
- Format e kontrollit të dijeve/ Frekuentimi / Kontrolli i vazhdueshëm: (renditen format e vlerësimit të studentëve të shprehura si përqindje e notës përfundimtare: niveli i diskutimit në seminare, kolokiumi, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit dhe provimi përfundimtar, etj.)
- Literatura (literatura paraqet listën e botimeve që studenti duhet të lexojë gjatë lëndës, e ndarë në a) literatura bazë e detyrueshme, b) literatura e rekomanduar)
- Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës: (hapësira ku pedagogu parashtron mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik, nëse ka)

Përsa i takon syllabuseve konstatojmë se kanë të gjitha elementet përberës të tij, në përputhje dhe me aktet nëligjore përkatëse.

Literatura në funksion të këtij programi studimi ishte në proces të përgatitjes së tyre në format hard copy. Studentëve i vihen në dispozicion temat e leksionit ose të seminareve në format hard copy ose në formë digjitale nga secili pedagog (kjo nga takimi me pedagogët dhe studentët).

Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (Tabela 10, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Stafi akademik ka kualifikimin dhe eksperiencën e duhur në përputhje me ketëksat e këtij programi studimi profesional. Nga takimi me stafin akademik u konstatua përkushtim dhe pasion në punën me studentin dhe mbarëvajtjen e programit

Vlerësimi sipas standardeve:

Standardi 6: Struktura e programit, rezultatet e të mësuarit dhe proceset e vlerësimit të mësimdhënies janë në përputhje me standardet evropiane.

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Programi është në përputhje me Bolonjën, Përshkruesit e Dublinit dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.

Kriteri 2 Studentët janë të pajisur me Supplementin e Diplomës që përputhet me rregulloret e BE-së për diplomim

Kriteri 3 Arritjet në nivelin 4 në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, lejojnë regjistrimin në këtë program studimi

Kriteri 4 Studentëve të regjistruar me formim dhe njohuri të ndryshme nga prurjet e zakonshme (jo tradicionale) u ofrohet mbështetje e duhur që në fazat e hershme të programit.

Kriteri 5 Programit ka 120 ECTS dhe lejon transferimin në vitin e 3, të një programi bachelor.

Kriteri 6 Ka një raport të balancuar 50:50 praktikë / teori në programin mësimor, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimin e studentëve.

Kriteri 7 Rreth 25% e programit është i vendosur në punë konkrete (p.sh. në një semestër ose i vendosur në pushimet e verës) ose në shkëmbime ndërkombëtare (p.sh. Erasmus +).

Kriteri 8 Mësimi praktik dhe elementëve të punës konkrete u është dhënë pesha e duhur në vlerësim dhe rivlerësim.

Vlerësimi sipas standardit 6:

Në takimet me stafin drejtues dhe personelin akademik u konstatua që programi i studimit është hartuar duke harmonizuar eksperiencën evropiane në arsimin profesional të fushës së dizenjimit , si dhe praktikën apo eksperiencën vendase në këtë drejtim. Ndërveprimi me sektorin privat të fushës ka patur një rol të rëndësishëm në hartimin e programit të studimit për të pajisur studentët me aftësi profesionale që tregu i punës kërkon.

Përmirësimet e programit të studimit (rritja e orëve të praktikës profesionale) për mendimin tonë, e ofrojnë këtë program me kërkesat e Nivelit 5 të KKK. Vlerësojmë faktin që, për shkak të specifikave të fushës, institucioni bën përmirësime në vijimësi të programit të studimit dhe adaptimin me ndryshime të tjera të mundshme, me qëllim përditësimin e tij me të rejtat teknologjike.

Plotësimi dhe përditësimi i syllabuseve në të gjitha elementët e saj, kryhej periodikisht. Programi i studimit profesional në Dizajn Grafik, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike/4 semestra. Raporti teori/praktikë është në favor të orëve praktike, sepse është rreth 1: 2.

Lëndët ndahen në disa kategori (nga A-E) sipas tipit të veprimtarisë të nohurive që transmetojnë. Orët e praktikës dhe laboreve janë gjithashtu të pranishme në shumicën e lëndëve të programit të studimit.

Projekti Final ka 18 kredite dhe parashikohet të përmbajë pjesë të praktikës profesionale dhe të përfundojë me një projekt konkret i kryer në kompani/studio dizenjimi ose në laboratorin e shkollës.

Studentët, pas përfundimit të studimeve 2 vjeçare mund të vazhdojnë studimet në nivelin Bachelor, mund të aplikojnë për këtë kalim dhe në mënyrë që kreditet e ngjashme t'iu ekuivalentohen, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Në këto raste ngrihet një komision për ekuivalentimin dhe njohjen e krediteve, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e studimit (*Neni 72, pika 2, Ligji 80/2015*).

Konkluzionet e GVJ:

Kurrikula e programit të studimit profesional në Dizajn Grafik, në vlerësimin tonë ofron plotësisht formim profesional në fushën e dizenjimit grafik. Procesi i rishikimit periodik të programit të studimit (plani mësimor dhe syllabuset përkatëse) bëhen në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies si dhe përditësimit të këtij programi me të rejtat me të fundit të fushës.

Rritja e orëve të praktikës profesionale bën të mundur që ky program të plotësojë kërkesat e Nivelit 5 të

KKK

Studentëve, pas përfundimit të këtij programi, u jepet mundësi për aplikim në programe universitare (ciklit të parë) duke iu mundësuar ekuivalentimin dhe njohjen lëndëve dhe krediteve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, dhe të akteve rregullatorë të shkollës

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj. (pika 2 të VKM nr. 41/2018)

Nga takimi me personelin akademik u konstatua se pedagogët në zbatim të praktikave akademike më të mira, dhe modeleve të huaja bashkëkohore, kanë futur metoda interaktive të cilat bazohen në ndërthurjen e teorisë me praktikën profesionale. Këto teknika mësimdhënie kanë për qëllim nxitjen e studentit për të qenë pjesë aktive e procesit nëpërmjet përdorimit të metodave interaktive. Ndërthurja e shpjegimit të metodave e teknikave specifike dizenjuese dhe aplikimi i tyre konkret nën mbikëqyrjen e pedagogëve të lëndës ndikon pozitivisht në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies për studentët programit profesional në Dizajn Grafik (kjo rezultoi dhe nga takimi me studentë të programit).

Praktika të tjera që aplikohen gjatë procesit të mësimdhënies janë edhe puna në grup dhe prezantimet.

Praktikat profesionale të studentëve dhe trajnimet e tyre organizohen në ambientet e shkollës (laboratorë) ose në institucione të tjera private a publike me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi si psh: AKZ studio, Shtëpia Botuese FLASH, etj. Në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit ato përshkruhen në mënyrë të detajuar në kapitullin “Marrëveshje dhe Bashkëpunime” (RVB).

Praktikat profesionale ndiqen dhe mbikëqyren nga departamenti dhe koordinatori i programit. Diplomimi bëhet me Projekt/detyre. Në syllabusin e lëndës/modulit shprehen modalitetet e vlerësimit të saj, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor.

Kontrolli i njohurive dhe format e kontrollit- Forma e kontrollit të dijes bëhet përmes sistemit të vlerësimit të vazhduar. Për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me 10 nota (nga 1 tek 10, ku 10 është vlerësimi maksimal). Shkalla e përvetësimit të dijeve me shkrim dhe/ose me gojë bëhet me pikë nga 0-100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë) (RVB)

Në vlerësimin përfundimtar të studentit në një disiplinë të caktuar merren në konsideratë të gjitha elementet përbërëse të zhvillimit të lëndës: pjesa teorike, pjesa e seminareve, projektet, kontrollet e pjeshme detyre kursi, etj. Përshtatja dhe detajet e këtij sistemi sipas specifikës së lëndës/ modulit përgatiten nga secili pedagog që në procesin e përgatitjes së programit të detajuar në syllabus.

Nga konkluzioni i deritanishëm rezulton se mënyra e vlerësimit me elementë të shumëfishtë dhe me pesha specifike të secilit prej tyre garanton kontrollin më të mirë nga ana e pedagogëve dhe në të njëjtën kohë nxit studentët për përgatitje më sistematike gjatë gjithë semestrit duke motivuar vëmendjen e tyre në të gjithë elementët e vlerësimit. Provimet zhvillohen brenda periudhave të caktuara në strukturën mësimore të vitit akademik. Format e kontrollit të dijes së një lënde/moduli mund të bëhet nëpërmjet:

- Provimit me shkrim
- Provimit me gojë

- Vlerësimi të projektit/detyrës së kursit
- Kombinimi të formave të mësimërme: me shkrim, me gojë, projekt dhe aplikim praktik.

Mënyra e organizimit të provimit është në funksion të natyrës së disiplinës. Ai përcaktohet nga pedagogu i lëndës, mbështetur në programin e lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Në format e kontrollit, me shkrim, përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit detyrimisht, kthehet në notë. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në tezën e cila gjatë provimit pajiset nga sekretaria me barkod individual për çdo student dhe çkodohet pas korrigjimit nga pedagogu, i cili hedh pikët e provimit në procesverbal ku paraprakisht ka plotësuar edhe pikët e mbledhura nga elementët e tjerë të vlerësimit.

Në syllabusin e lëndës përcaktohet edhe përqindja (pikëzimi) që zënë në vlerësimin total elementët e tjerë të kontrollit të dijeve si pjesëmarrja, detyrat, labororet, testimet gjatë vitit etj e cila aprovohet nga dekanati dhe varet nga natyra e disiplinës dhe ngarkesës në auditor.

Diplomimi- Si finalizim i të gjitha detyrimeve akademike studentët i nënshtrohen procesit të mbrojtjes së diplomës. Ky proces për programin profesional në Dizajn grafik përfshin paraqitjen dhe mbrojtjen e punimit të kryer prej tyre.

Në përfundimin me sukses të ciklit të studimit dhe mbrojtjes së diplomës, studenti pajiset me diplomë profesionale dhe emërtimin e diplomës së marrë. Forma dhe përmbajta e dokumentit të diplomës është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Diploma shoqërohet me listën e notave. Të gjithë dokumentet e sipërpërmendur përmbajnë elementët e sigurisë të vendosura nga institucioni.

Tregues të matshëm:

- Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies në programin e studimit, (Tabela 11, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Në tabelën 11 jepet ndarja e formave të mësimdhënies sipas orëve përkatëse. Referuar të dhënave rezultojnë se raporti teori/praktikë është ndjeshëm në favor të kësaj të fundit. Ky raport është shumë optimal për këto lloje programesh studimi i cili ka për qëllim formimin e profesionistëve me aftësi praktike e profesionale

- Format e kontrollit të njohurive (Tabela 12, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Duket qarte se vlerësimi dhe kontrolli i dijeve të studentëve bëhet bazuar në disa komponentë. Peshat specifike e këtyre komponentëve është në varësi të llojit të lëndës, përkatësisht për lëndët e formimit bazë dhe teorik u është caktuar një peshë më e madhe provimit ose testeve teorike, ndërsa për lëndët karakterizuese është caktuar një peshë më e madhe për projekte/detyra.

- Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njesisë jashtë procesit mësimor (Tabela 13, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Pavarësisht se është viti i dytë që ofrohet në UMT ky program studimi, rezultojnë se institucioni ka zhvilluar aktivitete apo veprimtari specifike të fushës së dizajnit me pjesëmarrjen e studentëve. Në këto aktivitete studentët kanë prezantuar/paraqitur, raste praktike e rekreative të punimeve të tyre (konfirmuar gjatë takimit të GVJ me studentët).

Konkluzione të vlerësimit:

Format e mësimdhënies dhe raporte midis tyre janë në përputhje me profilin profesional të programit të studimit. Kjo mbështetur dhe në raportet që dalin nga tabela nr.11, rezultojnë se orët totale në auditor zënë rreth 50% të orëve gjithsej. Orët totale në auditor (1475 orë) ndahen në orë leksioni/seminari (36%), orë laboratore/detyra, si

forma konkrete të mësimit teorik (34%) dhe praktika profesionale (30%) Kjo shpërndarje tregon se raporti orë teorike/orë praktike është në raportin 520/955 ose rreth 1:2.

Ky raport është optimal në programe të këtij lloji. Përqindja e lartë e orëve të laboratoreve dhe praktikës lëndore është mjaft e rëndësishme për vetë natyrën e programit të studimit, duke qenë se qëllimi final është përgatitja e profesionistëve me aftësi të mëdha praktike

Kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimit, teknologjitë e mësimit, vlerësimi i brendshëm i mësimit (i cili realizohet nga përgjegjësi i departamentit dhe nga NJSBC-ja), aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë.

Vlerësimi i studentit në këtë program studimi bazohet në disa komponentë. Vlerësimi final përfshin vlerësimin gjatë gjithë semestrit kur zhvillohet lënda, sipas peshës së ponderuar të disa elementëve, e cila është e ndryshme në përputhje me natyrën e lëndës: Pësha e secilit komponent vlerësimi jepet në syllabuset e secilës lëndë.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Kuotat e pranimit të studentëve për këtë program studimi miratohen nga Senati Akademik bazuar në planin e zhvillimit të institucionit. Përcaktimi i kuotave të pranimit mbështetet në standardet e miratuara të dhe në përputhje me :

- Kapacitetet njerëzore dhe logjistike dhe planin e zhvillimit të tyre.
- Standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për infrastrukturën, stafin akademik efektiv apo raportin pedagog/student.

Pranimi i studentëve në programin profesional në Dizajn grafik kryhet nëpërmjet platformës U-Albania. Ky proces rezulton të jetë kryer në përputhje me ligjin Nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", kuadrin nënligjor në fuqi për këto lloj programesh, si dhe kritereve të përcaktuara për çdo vit akademik në vendimet e Senatit Akademik për miratimin e kuotave dhe kritereve të pranimit për programet e studimit që ofron UMT-ja [Aneksi 17 RVB: Vendime të SA për miratimin e kuotave dhe kritereve të përzgjedhjes për vitin akademik 2017-2018 dhe 2018-2019].

Procedurat e pranimit të studentëve

Aplikimet e maturantëve për UMT kryhen nëpërmjet portalit të maturës shtetërore (U-Albania), procedura e përzgjedhjes dhe regjistrimit është transparente në zbatim të kritereve të përcaktuara dhe udhëzimeve të përvitshme të MASR për këtë proces.

Numri i studentëve të regjistruar. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 14, në aneks)

Referuar të dhënave të tabelës nr. 14, rezulton se cilësia në hyrje e studentëve ka një trend rritës (nga 5.68 në 6.07), ndërsa numri është gati i njëjtë. Siç kemi cituar dhe më lart kjo vjen si pasojë dhe të "rendjes" të maturantëve drejt diplomave universitare.

Vlerësimi sipas standardeve:

Standardi 3: Qasja e studentëve në mësimdhënie është mbështetur përmes hartimit të programit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Hartimi i Programit të studimit është mjaftueshëm fleksibël për të mundësuar që studimi të përshtatet me punësimin.

Kriteri 2 Përvojat e studentëve të fituara nga puna e tyre e mëparshme, janë integruar në modulet dhe vlerësimin e studentëve.

Kriteri 3 Përmbajtja e Programit është aktuale dhe i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe/ose kërkesat për aftësitë/shprehjet nga punëdhënësit.

Kriteri 4 Vlerësimi dhe feedback-u i studentëve është përdorur në mënyrë efektive, për të mbështetur studentët jo tradicionale dhe të mësuarit e nxënësveve performancë të ulët

Kriteri 5 Mësimdhënia përfshin metoda të ndryshme pedagogjike që i përshtaten studentëve të ndryshëm, p.sh. të mësuarit në veprim, puna në ekip dhe të mësuarit në formë të pavarur.

Vlerësimi sipas standardit 3:

Programi i studimit 2 vjeçar profesional në Dizajn Grafik realizohet me kohë të plotë, duke iu ofruar një orar mësimor fleksibël për studentët. Ky fleksibilitet ofrohet për ndjekjen e programit të studimit nga studentë të punësuar, apo dhe ata studentë të cilët janë punësuar gjatë kohës së studimeve. Procesi i pranimeve është kryer konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

UMT-ja i kushton vemëndje të veçantë procesit të mësimdhënies dhe për këtë arsye është aspekt i monitorimit të vazhdueshëm. Për pjesëmarrje aktive në mësim, studentët inkurajohen me metoda të cilat stimulojnë pjesëmarrjen e tyre, ndërveprimin në klasë.

Disa ndër metodat e mësimdhënies që janë përshkruar në syllabuse (RVB), të konfirmuara dhe në takimet me studentët, janë: *Puna në grup*: e cila inkurajohet me se shumti, sepse është një aftësi e kërkuar në tregun e punës; *Prezantime në publik*: ku studentëve iu kërkohet të bëjnë prezantime, për punët e tyre. Këto prezantime janë thelbësore në zhvillimin e aftësive të mira komunikuese dhe prezantuese, si dhe *Përdorimi i teknologjive të reja*: kjo shume e rëndësishme për programin profesional në Dizajn grafik. Laboratorët/mjediset e vizatimit janë ambiente ku studentët asimilojnë njohuritë e tyre praktike si dhe praktikohen në aspekte të veçanta të profesionit.

Praktikat profesionale: Praktikat profesionale në studiot e dizenjimit/shtëpi botuese etj janë të rëndësishme, sidomos për një program profesional jouniversitar. Në këtë mënyrë studentët mund të shohin nga afër implementime të dizenjimeve të ndryshme si dhe aspekte të tjera, të cilat nuk mund të demonstrohen apo aplikohen në laborator.

Standardi 4: Rezultatet e të mësuarit komunikohen që nga pranimi i studentëve deri në diplomim dhe janë shqyrtuar dhe vlerësuar

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Informacioni për mundësitë e regjistrimeve është i qartë dhe i publikuar, si dhe i mbështetur me udhëzime ndihmuese të stafit.

Kriteri 2 Ekziston një praktikë efektive e punës në ekip, midis stafit të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe stafit të IAL.

Kriteri 3 Synimet e programit dhe rezultatet e të mësuarit për elementët praktikë dhe akademikë janë të qarta, të mbështetura nga publikimi i rezultateve të të mësuarit në nivel moduli

Kriteri 4 Monitorimi i bibliotekës dhe i burimeve të tjera të mësimdhënies dhe të të nxënës është bërë rregullisht. Janë ndërmarrë rregullisht praktika specifike të punësimit dhe zhvillimi i aftësive.

Vlerësimi sipas standardit

Studentët marrin informacion të plotë dhe të përditësuar nga faqja zyrtare e universitetit si dhe nga mediat sociale (Facebook, Tëitter, LinkedIn, etj), ndërsa informacion për strukturën institucionale dhe programet e studimit, ju jepet nëpërmjet materialeve të printuara dhe të përgatitura posaçërisht për studentët e rinj apo kandidatët/aplikantët e rinj.

UMT-ja organizon vizita dhe prezantime në lidhje me ofertën akademike të përditësuar në institucionet e arsimit të mesëm, merr pjesë në panairt te ndryshme te punës që organizohen. Në këto vizita, përveç stafit te marketingut merrte pjese dhe stafi akademik, duke mundësuar takime apo përgjigje të drejtpërdrejta me nxënësite këtyre shkollave.

Për vlerësimin e lëndës, materialet didaktike në dispozicion të studentëve të këtij programi, studentët informohen nëpërmjet sekretarisë mësimore, nëpërmjet sistemit të menaxhimit informatik, në të cilën çdo student ka akses dhe merr marrë informacionin e dëshiruar, nëpërmjet koordinorit të programit apo dhe të përgjegjësit të departamentit (RVB dhe takimi me studentët dhe stafin).

Konkluzionet e GVJ:

Programi i studimit 2 vjeçar profesional në Dizajn Grafik realizohet me kohë të plotë, duke iu ofruar studentëve të punësuar një orar mësimor fleksibël.

Mësimdhënia cilësohet nga UMT si prioritet dhe ky aspekt është subjekt i monitorimit të vazhdueshëm.

Përvec metodave klasike të mësidhënies, për këtë program studimi janë futur dhe metoda të tjera si: *Puna në grup; Prezantime në publik; Përdorimi i teknologjive të reja*

Praktikat profesionale: Praktikat profesionale në studiot e dizenjimit/shtëpi botuese etj janë të rëndësishme, sidomos për një program profesional jouniversitar. Në këtë mënyrë studentët mund të shohin nga afër implementime të dizenjimeve të ndryshme si dhe aspekte të tjera, të cilat nuk mund të demonstrohen apo aplikohen në laborator.

Studentët marrin informacion të plotë dhe të përditësuar nga faqja zyrtare e universitetit si dhe nga mediat sociale (Facebook, Twitter, LinkedIn, etj), ndërsa informacion për strukturën institucionale dhe programet e studimit, ju jepet nëpërmjet materialeve të printuara dhe të përgatitura posaçërisht për studentët e rinj apo kandidatët/aplikantët e rinj.

UMT-ja organizon vizita dhe prezantime në lidhje me ofertën akademike të përditësuar në institucionet e arsimit të mesëm, merr pjesë në panairt te ndryshme te punës që organizohen. Në këto vizita, përveç stafit te marketingut merrte pjese dhe stafi akademik, duke mundësuar takime apo përgjigje të drejtpërdrejta me nxënësite këtyre shkollave.

Për vlerësimin e lëndës, materialet didaktike në dispozicion të studentëve të këtij programi, studentët informohen nëpërmjet sekretarisë mësimore, nëpërmjet sistemit të menaxhimit informatik, në të cilën çdo student ka akses dhe merr marrë informacionin e dëshiruar, nëpërmjet koordinorit të programit apo dhe të përgjegjësit të departamentit (RVB dhe takimi me studentët dhe stafin).

10. Aktivitetet profesionale në funksion të programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e njohurive me praktikën profesionale, vlerësimet zyrtare të aktivitetit individual të studentëve ose në njësinë.

Universiteti Metropolitan Tirana ka organizuar disa aktivitete në fushën e dizenjimit grafik Organizimi i aktiviteteve dhe pjesëmarrja aktive të studentëve (referuar RVB) ka qene relativisht e lartë. Këto aktivitete kanë pasur objektiva, që lidhen me formimin profesional të studentëve.

Aktivitetet dhe veprimtaritë në të cilat studentët e programit 2 vjeçar Jouniversitar profesional në Dizajn Grafik janë përfshirë, janë si më poshtë (nga RVB):

- *Ekspozita me punime (28-29 nëntor 2018) në: Fotografinë/Videot/Skicat/Instalacionet/Skulpturën/ Punimet artizanale*
- *Konkursi "Skëndërbeu në kohë"*
- *Ekspozite studentore. Edicioni i parë. zhvilluar në maj 2018*
- *Punime grafike, kapaku i disa librave që po shkruhen nga pedagogë të UMT*
- *Formatimi grafik dhe unifikimi i leksioneve të Kursit të Vlerësimit të pasurive të paluajtshme*
- *Konkurs me nxenes dhe studente për logon e Metrodesign (nga UMT)*
- *Vizita të studentëve pranë disa studio grafike dhe shtëpi botuese si:*
 - *Studio grafike "EDERSTUDIO"*
 - *Studio grafike "Akz Creative Studio",*
 - *Studio grafike "Grafitec.al".*
 - *Shtëpia Botuese "FLESH".*
 - *Arkivi Qendror Teknik*

Gjatë vizitës GVJ u njoh me dokumentacionin e plotë të këtyre aktiviteteve. Edhe nga intervistat me studentë këto aktivitete u përmendën si raste shumë të mira për të për punesimet e ardhshme, ose për rritjen e tyre profesionale.

Konkluzionet e GVJ:

Në gjykimin e GVJ, vlerësohet se aktivitetet e organizuara shërbenin më së mirë për rritjen profesionale të studentëve, si dhe të socializimit të tyre.

11. Bashkëpunimi kombëtar (dhe ndërkombëtar)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Bashkëpunimet e realizuara nga njësi kryesore me tregun e punës që lidhet me këtë program studimi, si në nivel rajonal ashtu edhe në nivel kombëtar/ ndërkombëtar. Përfitimet institucionale, në nivel program apo në nivel studentësh gjatë këtyre bashkëpunimeve.

UMT, në strategjinë e vet të zhvillimit [Aneksi 7]: Plani strategjik i institucionit], ka si prioritet bashkëpunimin si në nivel kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

Referuar RVB dhe takimeve me drejtuesit e institucionit si dhe zyrën përgjegjëse për marrëdhëniet me jashtë, kontatojmë se UMT ka nënshkruar marrëveshje me partnerë lokalë, rajonalë si dhe ndërkombëtarë. Ky rrjet partnerësh ka mundësuar bashkëpunime të cilat përfshijnë organizimin e programeve të studimit të përbashkëta, në organizimin e projekteve kërkimore të përbashkët, konferencave, seminareve dhe workshopeve.

UMT-ja ka bërë përpjekje për realizimin e marrëveshjeve specifike me kompani të fushës së dizajnit me qëllim vendosjen e marrëdhënieve me stafin akademik efektiv dhe të jashtëm profesionist, për konsolidimin e planit mësimor, kryerjes së praktikave profesionale etj.

Gjithashtu, në funksion të realizimit të objektivit strategjik lidhur me ndërkombëtarizimin e veprimtarisë akademike dhe kërkimore shkencore, në kuadër të programit Erasmus+, institucioni ka realizuar shkëmbimet e

mëposhtme akademike për studentët dhe stafin e tij, që sic u deklarua dhe nga personeli akademik dhe njësitë përkatëse ky numër është dukshëm më i lartë se vitet e tjera, falë marrëveshjeve ndërkombëtare të bashkëpunimit me universitetet pritëse.

Lista e kompanive me të cilat është firmosur një marrëveshje bashkëpunimi specifikisht për programin profesional në Dizajn Grafik, është dhënë në Tabelën 15.

GVJ u njoh me marrëveshjet e referuara në këtë Tabelë. Kompanitë më të cilat janë lidhur marrëveshjet japin mundësi studentëve për realizimin e praktikave profesionale duke mundësuar dhe afrimin e studentëve me tregun e punës, aftësimin praktik në to

ANALIZA SWOT

Analiza përmbledhëse sipas metodës SWOT (Strengths, Weaknesses-, Opportunities, Threats).

a. Pika të forta:

1. Programi i studimit profesional 2 vjeçar (jo universitar) profesional në Dizajn Grafik vjen si përgjigje e politikave dhe strategjisë të zhvillimit kombëtar, për t'i ofruar tregut të punës, profesionistë me aftësitë e duhura jo vetëm teorike por sidomos praktike.
2. Zhvillimi i teknologjisë së informacionit ndërthurur me kreativitetin artistik është aktual si për kontekstin Shqiptar po ashtu dhe në nivel Evropian e më gjerë dhe përbëjnë prioritet të politikave të zhvillimit kombëtare dhe ndërkombëtare.
3. Programi i studimit rezulton të jetë i qëndrueshëm pasi është hartuar bazuar në praktikatat më të mira evropiane dhe në kërkesat e biznesit lokal.
4. Zhvillimi i procesit mësimor mbështetet me infrastrukture të plotë e të mirëpajisur, kjo për shkak dhe të profilit të teknologjisë së informacioni që ka UMT-ja, gjë që ndihmon në arritjen e standardeve sa më të larta akademike e praktike në zhvillimin e programit.
5. Monitorimi i cilësisë së programit që garanton kontroll dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë.
6. Programi mundëson transferimin e krediteve në programe universitare të nivelit Bachelor.
7. Përmirësimi i syllabuseve (pa u mbyllur cikli), duke u fokusuar tek elementet specifike të saj.

b. Pika të dobëta (ose pikat ku ka vend për përmirësim):

1. Evidentohet një mungesë literature mësimore të përshtatshme për nivelin e edukimit profesional, për shkak se ky program në nivel profesional nuk zhvillohet në asnjë nga shkollat e larta të vendit tonë (ka IAL që e ofrojnë si diplomë universitare Bachelor/master), dhe materialet që ekzistojnë janë kryesisht të një natyre teorike dhe jo të përshtatshme për edukim profesional. Si rezultat, literatura me karakter profesional, po zhvillohet hap pas hapi me zhvillimin e programit të studimit për herë të parë nga profesionistët e fushës.

c. Mundësitë:

1. Arsimi profesional 2 vjeçar, që përcaktohet si niveli 5-të në kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe atë Evropiane, ka prioritet në fushën e Edukimit profesional, prioritet që është artikuluar qartë nga Qeverisë Shqiptare.
2. Mundësi për integrim të shpejtë në tregun e punës të të diplomuarve nga ky program studimi.
3. Mundësi për korrigjimin e mangësive (pikave të dobëta) në këtë program studimi, sepse UMT ka në fokus zhvillimin e programeve profesionale që ofron.

d. Pengesat:

1. Ndërmarrjet që operojnë në fushën dizenjimit nuk angazhohen sa duhet apo të shfaqin interesin e duhur për zhvillimin e praktikës profesionale, e cila zë peshë të rëndësishme të volumit mësimor dhe krediteve.

2. Shkollat e mesme profesionale apo të përgjithshme, në më të shumtit e rasteve, nuk arrijnë ti pajisin të diplomuarit me të gjitha njohuritë e parashikuara, gjë që e bën më sfiduese punën me ta në nivel post-sekondar.

Rekomandime:

1. Institucioni, të vijojë me hartimin dhe zhvillimin e literaturës mësimore nga profesionistë të fushës, të përshtatshme për nivelin e edukimit profesional që ofron ky program studimi.

SWOT ANALYSE

Summary Analysis by SWOT (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats)

a. Strong points

1. The 2 year (non-university) professional study program, in Graphic Design program it is applied as a response to the national development of policies and strategies to provide to the labor market professionals with the necessary skills, not only theoretical but especially with practical ones.
2. The development of the information technology combined with artistic creativity is present for both Albanian and European context and beyond, and constitute a priority of national and international development policies.
3. The study program results to be sustainable, as it is designed based on the best European practices and local business requirements.
4. The development of the teaching process is fully supported and well-equipped infrastructure due to the UMT's information technology profile, which helps to achieve the highest academic and practical standards in the development of the program.
5. Monitoring the program quality ensures the improvement and continuous quality control.
6. The program enables the possibility to transfer the credits of university programs in Bachelor level.
7. Improving syllabus (during the same level of studies), focusing on its specific elements.

b. Weak point (or points where there are opportunities for improvement)

1. There is a lack of appropriate teaching literature, for the vocational education level, because this study program of vocational level it is not offered in any other university of our country (there are some universities that offer this program as a Bachelor/Master level), and materials that exist are mostly of a theoretical nature and not suitable for vocational education. As a result, vocational literature is being developed step by step with the development of the study program for the first time by its professionals.

c. Improvement opportunities

1. The 2 year vocational education, is defined as the 5th level in the Albanian Qualifications Framework and the European Framework. It has priority in the field of Vocational Education, a priority that is clearly articulated by the Albanian Government.
2. Rapid integration opportunities into the labor market of graduates from this study program.
3. Opportunity to correct deficiencies (weak points) in this study program, because UMT focus is on the development of professional programs, that this institution offers.


d. Threats

1. Enterprises operating in the design field are not sufficiently engaged and do not demonstrate the proper interest in developing professional practices, which plays an important role in teaching and in credits.
2. Vocational or general secondary schools, in most cases, fail to provide graduates with all the anticipated knowledge, which makes their work more challenging at post-secondary level.

Recommendations:

1. *Institution must continue with the drafting and the development of teaching literature by the field professionals, that are appropriate for the level of vocational education offered by this study program.*

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm



Dr. Gjergj Thomai

Dr. Elvan Dajko

